



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-13805 21
Kaçanik, 21.05.2021

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e V-të (Pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 28 Maj 2021 (e Premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 28.05.2021 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Tremujor Financiar, për periudhën: Janar-Mars 2021;
3. Rishqyrtimi i Propozim Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m², në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës “Ismail Raka” – segmenti nga shtëpia e kulturës “Xheladin Kurtaj” deri të “Xhamia e Dëshmorëve” në Kaçanik;
4. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë në pjesë të parcelave kadastrale: 457-0; 459-0; 460-0, ZK Ivajë, sip. 419m², pronë e Mefail Rexha, në këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01065-10, në sip. 418m², ZK Ivajë, P.SH. Rrugët publike të pa kategorizuara.

Shtojca; Materialet për pikët sipas agjendës.